

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Tonka Berishaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtoren profesionale Kimete Veseli procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit M.Q., nga Prizreni, për shkak të veprës penale Grabitje nga neni 329 par. 1 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorisë Themelore – DKR në Prizren dhe mbrojtësit të akuzuarit M.Q., av. V.O., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore – DKR në Prizren, PKR.nr.87/17 të datën 05.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, më datë 06.04.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore – DKR në Prizren dhe mbrojtësit të akuzuarit M.Q., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore – DKR në Prizren, PKR.nr.87/2017, të dt. 05.12.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore – DKR në Prizren, me aktgjykimin PKR.nr.87/2017, të dt. 05.12.2017, e ka shpallur fajtor të akuzuarin M.Q. për shkak të veprës penale grabitje nga neni 329 par. 1 të KPK-së, dhe për këtë veprë penale e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjetësh, në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 04.05.2017 deri më datën 05.12.2017, si dhe me dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesë qind) €, dënim ky i cili do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa, nëse dënimi me gjobë refuzon ta paguajë i akuzuari, atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do t'i llogaritet në shumë prej 20 €.

I akuzuari është obliguar që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, shumë prej 200 (dy qind) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

E dëmtuara H.T. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në procedurë kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesa kanë paraqitur:

Prokuroria Themelore – DKR në Prizren, për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.Q., av. V.O., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që i akuzuari M.Q. të lirohet nga akuza apo të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konformë dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën njoftoi Prokurorinë e Apelit, të dëmtuarën, të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij av. V.O.. Në seancën e kolegjit ishin të pranishëm i akuzuari M.Q. dhe mbrojtësi i tij av. V.O., ndërsa, edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt në seancë të kolegjit nuk prezantuan Prokurori i Apelit, e as e dëmtuara H.T.. Mbrojtësi i të akuzuarit av. V.O., pasi sqaroi disa nga pretendimet ankimore, theksoi se qëndron në tërësi pranë propozimeve si në ankesë, të cilin e mbështeti edhe i akuzuari M.Q., po ashtu prezentë në seancën e kolegjit.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me parashtresën PPA/I.nr.96/18, të dt. 05.03.2018, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore – DKR në Prizren, të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim, ndërsa, ankesa e mbrojtësit të akuzuarit M.Q., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa, gjeti se:

Ankesat nuk janë të bazuara.

Pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.Q., av. V.O., në ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par. 8 dhe 12 e lidhur me nenet 260, par. 3 e 7, nenin 262 par. 2 dhe nenin 347 par. 2 të KPPK-së, sepse sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij dhe me arsyerat e aktgjykimit, në të nuk janë paraqitur arsyeza lidhur me faktet vendimtare, ndërsa, ato pak arsyeza të paraqitura janë në kundërthënie ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave, se aktgjykimi bazohet edhe në prova të pa pranueshme, pra, deklaratën e të akuzuarit të dhënë në procedurë paraprake, pastaj, në aktgjykimin e ankimuar nuk janë dhënë arsyeza për propozimin e refuzuar të mbrojtësit të akuzuarit për ballafaqimin e të akuzuarit me të miturin, shkelje këto të gjitha që ndikojnë domosdoshmërisht në anulimin e aktgjykimit të ankimuar. Sipas pretendimeve ankimore të mbrojtësit të akuzuarit M.Q., aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cekura më lartë, ngase, sikur që të mos kishte bërë shkeljet në fjalë, atëherë, me siguri që i akuzuari do të lirohej nga akuza, duke theksuar më tutje, se gjykata e shkallës së parë, sidomos ka shkelur dispozitat e nenit 3 dhe 7 të KPPK-së, ngase, për vërtetimin e fakteve themelore në një çështje penale-juridike, atëherë, duhet që interpretimi i provave të bëhet në favor të akuzuarit, e jo sikur që ka vepruar gjykata e shkallës së parë, ku në rastin konkret, ka marrë parasysh vetëm provat që janë në disfavor të akuzuarit, pastaj, e njëjta po ashtu, nuk ka zbatuar dispozitat e nenit 260 të KPPK-së, ngase, nuk ka bërë më parë, vlerësimin e çdo prove veç e veç, e pastaj, të nxjerrë konkludimet e saja, por në rastin konkret ka vendosur vetëm në bazë të deklaratës së të akuzuarit të dhënë në polici, pra, pa marrë parasysh edhe provat tjera në shkresat e lëndës, e sidomos nuk ka marrë parasysh se deklarata në fjalë është provë e papranueshme, ngase është marrë pa praninë e mbrojtësit të akuzuarit, që do të thotë se nuk janë respektuar dispozitat procedurale për marrjen në pyetje në procedurë paraprake, sikur që parashihet në dispozitat e KPPK-së. Po ashtu, është me rëndësi për t'u theksuar se edhe nga vetë deklarata e të dëmtuarës, e cila edhe ashtu nuk e ka bërë identifikimin e të akuzuarit nuk vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtorë, kurse gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin e saj e bazon pikërisht në këtë deklaratë, e pastaj, në faktin se edhe i mituri është shpallur përgjegjës për vepër të njëjtë penale e për të cilën pretendohet se e ka kryer në bashkëkryerje me të akuzuarin, gjë që, asnjëra nga provat në fjalë nuk argumentojnë se i akuzuari ka kryer veprën penale grabitje nga neni 329 par. 1 të KPK-së, sikur që pretendohet në aktakuzë. Prandaj, gjithëherë sipas pretendimeve ankimore, sikur të çmoheshin dhe të vlerësoheshin të gjitha provat veç e veç dhe më pastaj të gjitha së bashku, e pastaj të nxjerrë konkludimet e saja, atëherë, me siguri që gjykata e shkallës së parë, do të kishte marrë aktgjykim tjetër dhe atë të ligjshëm dhe të drejtë, me të cilin edhe të akuzuarin do ta lironte nga akuza, kuptohet, në mungesë të provave me të cilat do të vërtetohej si i akuzuari ka kryer veprën penale grabitje nga neni 329 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet e lartë cekura ankimore janë të pabazuara, ngase, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara nga neni 384 par. 1 nën par.12 e lidhur me dispozitat e nenit 3, 7, 347 par. 2, 262 par. 2 dhe nenit 260 të KPPK-së, ngase, s'pari dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, ngase, në dispozitiv janë paraqitur të gjitha veprimet inkriminuese të akuzuarit që përbëjnë elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtor i akuzuari M.Q.. Pastaj, në arsyetim janë dhënë arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje penale-juridike, duke përfshirë si ato faktike dhe juridike, ngase, gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 361 par. 2 kurse, për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 370 par.7 të KPPK, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyrash i merr i të provuara ose si të pa provuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore, pra ajo ka bërë analizën e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë. Prandaj, përveç që qasja ndaj fakteve vendimtare ka qenë e drejtë dhe e ligjshme as një fakt nuk ka ngelur i pa qartësuar ose i pavërtetuar dhe përveç që janë vërtetuar drejtë ato edhe janë arsyetuar në mënyrë të plotë dhe të saktë, ku ka dhënë vlerësimin e saj si për deklaratën e të dëmtuarës, të vetë të akuzuarit dhe atë si për atë të dhënë në shqyrtimin gjyqësor edhe për deklaratën e dhënë në polici. Kështu, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës penale e po ashtu e njëjta ka marrë parasysh edhe mbrojtjen e të akuzuarit, duke konstatuar se i njëjti, nuk ka pranuar se ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, deklaratë kjo e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, e të cilën me të drejtë e ka vlerësuar si të pa bazë dhe të paargumentuar, pastaj ka marrë parasysh edhe deklaratën e dhënë në polici, nga e cila ka vërtetuar faktet dhe rrethanat e përshkruara më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, për çka gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme edhe përkitazi me pretendimin e mbrojtjes së deklaratë e të akuzuarit e dhënë në polici, është provë e papranueshme, gjë që, edhe nuk e ka aprovuar, ngase, sipas shkresave në lëndë në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar se deklarata në fjalë është dhënë dhe nënshkruar në prezencën e mbrojtësit të akuzuarit, pra, av. Agim kabashi, i cili edhe e ka nënshkruar deklaratën në fjalë, pra, personalisht vetë i akuzuari, pastaj mbrojtësi i tij dhe personi zyrtar që e ka marrë në pyetje, prandaj, nuk qëndron pretendimi ankimor se deklarata në fjalë nuk është marrë në përputhshmëri me dispozitat procedurale për marrjen në pyetje sipas KPPK-së. Prandaj, duke pasur parasysh të cekurat si më lartë, me të drejtë gjykata e shkallës së parë, nuk ka aprovuar po ashtu, as propozimin e mbrojtësit të akuzuarit për ballafaqimin e të akuzuarit me të miturin, ngase, përveç arsyerave të dhëna

nga gjykata e shkallës së parë, po ashtu, kjo gjykatë konstaton se pasi që me provat tjera të proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, është vërtetuar në mënyrë të argumentuar gjendja faktike dhe atë pikërisht, edhe përkitazi me prezencën dhe identifikimin e të akuzuarit M.Q., atëherë, pa dyshim që nuk ka qenë e nevojshme që të dëgjohet gjegjësisht të ballafaqohet i mituri me të akuzuarin, kur faktet dhe rrethanat themelore në këtë çështje penale-juridike, sikur që u tha më lartë, janë vërtetuar me provat tjera të proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ligjit penal dhe gjetjet e gjykatës.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike me ankesa në esencë kontestohet vetëm mënyra e vlerësimit të provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë, si dhe konkludimet të cilat ajo i ka nxjerrë të bazë të provave të proceduara. Pretendohet se provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe të njëanshme, ngase, së pari, nga deklarata e dëshmitares – të dëmtuarës H.T., nuk vërtetohet se i akuzuari M.Q., ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, pastaj, një gjë e tillë po ashtu nuk vërtetohet as nga deklarata e të miturit, i cili në deklaratën e tij nuk e ka inkriminuar fare tani të akuzuarin M.Q., ndërsa, sa i përket deklaratës së të akuzuarit të dhënë në procedurë paraprake, e njëjta sikur që u tha edhe më lartë është provë e papranueshme, prandaj, duke marrë parasysh të gjitha këto rezulton se përfundimet e gjykatës së shkallës së parë, janë të gabuara e pa mbështetje në prova, për çka, i akuzuari M.Q., është dashur të lirohet nga akuza, e jo të shpallet fajtor, sikur që ka vepruar gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë, ngase, në këtë çështje penale-juridike, gjykata e shkallës së parë, pa mëdyshje ka vërtetuar gjendja faktike të përshkruar më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, ku, pra, edhe nuk kontestohet vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së veprës penale, pra, fakti se dy persona janë futur në shtëpinë e të dëmtuarës dhe me përdorimin e dhunës dhe kanosjes edhe kanë marrë gjësende nga shtëpia e të dëmtuarës, mirëpo, kontestuese mbesin faktet dhe rrethanat, se përveç të miturit natën kritike a ishte edhe i akuzuari në shtëpinë e të dëmtuarës së bashku me të miturin, apo bëhet fjalë për persona të tjerë.

Prandaj, përkitazi me faktet kontestuese, në këtë çështje penale-juridike, gjykata e shkallës së parë, përveç deklaratës së të dëmtuarës – dëshmitares H.T., nga e cila ka vërtetuar se natën kritike në shtëpinë e saj janë futur dy persona dhe atë pasi më parë kanë thyer xhamin e derës së hyrjes së shtëpisë, menjëherë në korridor kanë takuar të dëmtuarin, të cilës i mituri ia ka mbyllur gojën kurse personi tjetër i maskuar – i cili kishte vënë në kokë një çorapë, i ofrohet të dëmtuarës dhe me thikë në dorë duke iu kërcënuar, pastaj, ia marrin gjësendet e përshkruara më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, ka marrë parasysh edhe deklaratën e dëshmitarit B.Xh., i cili ka vërtetuar se telefonin mobil të markës “Samsung” e kishte blerë nga tani i akuzuari M.Q. dhe atë vetëm në shumë prej 2,00 €, telefon ky për të cilin, përmes provave materiale por edhe deklaratës së të

dëmtuarës është vërtetuar se ka qenë telefoni i të dëmtuarës, i cili është marrë natën kritike kur edhe ka ndodhur kryerja e veprës penale, pastaj deklaratën e vetë të akuzuarit të dhënë në procedurë paraprake, i cili në tërësi e ka pranuar kryerjen e veprës penale duke përshkruar të gjitha faktet dhe rrethanat përkitazi me mënyrën e kryerjes, përdorimin e kanosjes ndaj të dëmtuarës si dhe faktin se gjatë kryerjes së veprës penale kanë qenë së bashku edhe me të miturin, fakte këto dhe rrethana që po ashtu, janë vërtetuar edhe përmes provave materiale në shkresat e lëndës. Përkitazi me faktet kontestuese, gjykata e shkallës së parë, ka marrë parasysh edhe mbrojtjen e të akuzuarit se telefonin në fjalë e ka blerë prej një personi tjetër dhe se pastaj, personi në fjalë ia ka shitur të akuzuarit, mirëpo, përkitazi me këtë, i njëjti nuk ka arritur që ta argumentojë një gjë të tillë, duke treguar, pra, personin me emër dhe mbiemër, e pastaj edhe adresën-pra, ta bëjë identifikimin e të njëjtit, e që të mund të dëgjohet si dëshmitar, për çka, gjykata e shkallës së parë, një pretendim të tillë e ka refuzuar si të pabazë dhe të paargumentuar, për çka, një vlerësim të tillë e aprovon si të drejtë dhe të ligjshëm edhe kjo gjykatë.

Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartë përmendura si dhe rrethanat dhe arsyerat më detajisht të theksuara në aktgjykimin e ankimuar, rezulton se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë, se i akuzuari M.Q., është kryerësi i veprës penale të grabitjes nga neni 329 par. 1 të KPK-së, është i drejtë dhe se në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se i akuzuari ka ndërmarrë veprime inkriminuese të cilat përbëjnë tiparet e veprës penale për të cilën i akuzuari edhe është shpallur fajtor, prandaj, nuk qëndron pretendimi ankimor se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, kur i njëjti është shpallur fajtor për vepër penale grabitje nga neni 329 par. 1 të KPK-së.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore dhe mbrojtësit të akuzuarit nuk janë të bazuara.

Në ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren, përkitazi me këtë bazë ankimore theksohet se shkalla e rrezikshmërisë shoqërore është e madhe, se nuk është marrë parasysh fakti se veprat penale në fjalë janë në rritje, se dënimi nuk është në harmoni me vlerën e mbrojtjes juridike, me intensitetin e shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit, se ka edhe rrethana tjera rënduese që nuk janë marrë parasysh, si përdorimi i dhunës dhe kanosjes, se viktima ka qenë person i moshuar, pastaj, se gabimisht është marrë si rrethanë lehtësuese sjellja e të akuzuarit gjatë seancë së shqyrtimit kryesor, për çka, edhe propozon që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, ndërsa, mbrojtësi i të akuzuarit M.Q., në ankesën e tij, përkitazi me këtë bazë ankimore, nuk thotë asgjë konkretisht në arsyetim se aktgjykimi në fjalë është i paligjshëm, prandaj edhe nuk ka nevojë fare që të akuzuarit t'i shqiptohet dënimi, sikur që ka vepruar gjykata e shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në

caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit siç parasheh dispozita e nenit 73 dhe 74 të KPK-së. Pretendimet e Prokurorisë Themelore – DKR në Prizren, nuk janë të bazuara, ngase, disa nga rrethanat rënduese të cilat ceken me ankesë, të njëjtat janë të përfshira në elementet qenësore të veprave penale për të cilat i akuzuari është shpallur fajtor, ndërsa, disa të tjerat krahasuar me rrethanat lehtësuese nuk janë të asaj natyre që do të ndikonin që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i ashpër se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, ndërsa, nga mbrojtësi i të akuzuarit edhe ashtu nuk cekët asnjë rrethanë tjetër konkrete lehtësuese që do të ndikonte në zbutjen e mëtutjeshme të dënimit. Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e konstatuara në aktgjykimin e ankimuar, rrethanat e rastit konkret, mënyrën se si është zhvilluar ngjarja kritike, kontributin e veprimtarisë inkriminuese të akuzuarit, rezulton se dënimi të cilin i ka shqiptuar të akuzuarit gjykata e shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm, po ashtu, është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, është në funksion të preventivës gjenerale dhe individuale dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPK.

Nga sa u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.96/2018, të dt. 06.04.2018

**Procesmbajtëse,
Kimete Veseli**

Anëtarët e kolegjit,

1. Xhevdet Abazi

2. Tonka Berishaj

**Kryetari i kolegjit,
Abdullah Ahmeti**